

L I G J

Nr.7570, datë 3.6.1992

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 “PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, para kreut III/a shtohet një kre me këtë përmbajtje:

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I PUSHTETIT LOKAL

Neni 1

Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në komuna, bashki dhe rrethe.
Në çdo komunë, bashki dhe rreth organizohet dhe funksionon pushteti lokal.

Neni 2

Organet e pushtetit lokal zgjidhen drejtpërsëdrejti nga populli me zgjedhje të lira, të përgjithshme, të barabarta dhe të fshehta.
Mënyra e zgjedhjes së organeve të pushtetit lokal caktohet me ligj.

Neni 3

Organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal bëhet mbi bazën e parimeve të vetëqeverisjes, të pavarësisë, të autonomisë lokale dhe të decentralizimit.
Organet e pushtetit lokal në veprimtarinë që kryejnë mbështeten në dispozitat kushtetuese, ligjet dhe aktet e nxjerra në bazë e për zbatimin e tyre.
Parimet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit lokal nuk mund të cenojnë karakterin unik kombëtar të shtetit shqiptar.
Kompetencat e organeve të pushtetit lokal caktohen me ligj.

Neni 4

Njësitë më të vogla në organizimin e pushtetit lokal janë komuna dhe bashkia.
Në përbërjen e komunës mund të hyjnë disa fshatra ose një qytet i vogël me disa fshatra.
Organet e komunës janë: këshilli i komunës dhe kryetari i komunës.
Ndryshimi i kufijve të komunës bëhet pasi të jetë marrë miratimi i banorëve të saj që gëzojnë të drejtën e votës.

Neni 5

Bashkitë krijohen në qytete që nuk përfshihen në komuna.
Organet e bashkisë janë: këshilli i bashkisë dhe kryetari i bashkisë.
Organizimi dhe funksionimi i bashkisë së kryeqytetit caktohen me ligj.

Neni 6

Në komuna e bashki krijohen nëndarje më të vogla administrative tokësore. Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të organeve të tyre caktohen me ligj.

Neni 7

Rrethi formohet nga disa komuna dhe bashki që lidhen ndërmjet tyre.
Organi përfaqësues në rreth është këshilli i rrethit.
Këshilli i rrethit zgjedh kryesinë dhe kryetarin e saj, që janë organet ekzekutive.

Neni 8

Organet e pushtetit të rrethit, kanë për detyrë të bashkërendojnë veprimtarinë e komunave dhe të bashkive brenda territorit të tyre.

Neni 9

Anëtarët e këshillave nuk përgjigjen për mendimet e shprehura dhe votën e dhënë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Rastet e papajtueshmërisë së funksionit të anëtarit të këshillit me funksione të tjera caktohen me ligj.

Neni 10

Organet e pushtetit lokal janë persona juridikë. Ata kanë pasuritë që u njihen me ligj dhe zhvillojnë veprimtari ekonomike brenda e jashtë territorit të tyre.

Neni 11

Organet e pushtetit lokal kanë buxhetin e tyre.
Burimet financiare e mënyra e përdorimit të tyre si dhe detyrimet ndaj shteti, caktohen me ligj.
Për komuna dhe bashki të veçanta shteti parashikon kontribute financiare.

Neni 12

Organet e zgjedhura të pushtetit lokal mund të shpërndahen vetëm në rastet e parashikuar me ligj.

Shpërndarja e organeve të zgjedhura të pushtetit lokal bëhet me dekret të motivuar nga Presidenti i Republikës, sipas propozimit të bërë nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Organet e pushtetit lokal kanë të drejtë të nxjerrin akte normative që veprojnë brenda territorit të njësisë administrative tokësore përkatëse.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.202, datë 5.6.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha